

~~DRAFT~~



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYETARI

VENDIM  
Nr. 14838/ datë 7.5.2021

“PËR  
MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2021”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 64, shkronja “a” të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 48492, datë 20.12.2019 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë Tiranë”, vendimit nr 160, datë 21.12.2018 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qendrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018 – 2022”, si dhe në vijim të Memos me nr. 14838 prot., datë 09.04.2021 të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Jetësimit të Prioriteteve, me lëndë “Miratimin e Planit Strategjik të Bashkisë Tiranë për vitin 2021”,

VENDOS:

1. Miratimin e Planit Strategjik të Bashkisë Tiranë për vitin 2021, sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha drejtoritë e përgjithshme të aparatit të Bashkisë Tiranë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion VELIAJ







# PLANI STRATEGJIK BASHKIA TIRANË Viti 2021

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE  
BURIMEVE NJERËZORE

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Misioni i Bashkisë Tiranë është sigurimi i një qeverisje të drejtë, efikase me qytetarët duke njohur dhe respektuar ekzistencën e identiteteve dhe vlerave të ndryshme të komunitetit, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të tyre, duke mbështetur dhe siguruar mirëqënie dhe duke garantuar standarde bashkëkohore në ofrimin e shërbimeve, mjedis të shëndetshëm, vlera të larta të bashkëjetesës komunitare dhe një ndjenjë të pronësisë/zotërimit mes banorëve mbi të mirat publike.

Për të përmbushur këtë mision Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore, ka hartuar Planin Strategjik të Bashkisë Tiranë për vitin 2021 (PSBT), një dokument që përmban prioritetet dhe objektivat e institucionit, të detajuara dhe grupuara sipas 11 Drejtorive të Përgjithshme. Për çdo drejtori të përgjithshme janë përcaktuar objektivat dhe projektet apo aktivitetet që do të zhvillohen nga strukturat e të gjithë aparatit të BT-së. Bazuar tek funksionet që ka çdo drejtori janë përcaktuar njësite përgjegjëse dhe njësitë mbështetëse për realizimin e këtij plani.

PSBT 2021 përcakton në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet të cilat duhet të ndërmerren për t'i arritur objektivat dhe prioritetet strategjike. PSBT është përpiluar në bazë të: (i) Funksioneve, kompetencave dhe detyrave të përcaktuara nga kuadri ligjor dhe rregullorja e BT-së, (ii) Prioriteteve dhe objektivave të përcaktuara nga Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018 – 2022, (iii) Platformës socio-ekonomike të Kryetarit të Bashkisë, (iv) Buxhetit të miratuar në Këshill Bashkiak viti 2020 dhe (v) Planeve vjetore të strukturave të BT-së.

Në këtë dokument janë specifikuar prioritetet e vitit 2021, të detajuara në objektiva, programe, projekte/aktivitete dhe në indikatorë të monitorueshëm për të gjitha drejtoritë e BT-së. Në disa raste ka më shumë se një strukturë përgjegjëse për përmbushjen e një objektivi apo projekti, kjo nisur nga kompleksiteti që kanë disa projekte dhe ndërthurja e kompetencave. Jo të gjitha drejtoritë e aparatit qendror kanë ndikim/përgjegjësi direkte në realizimin e objektivave të institucionit, pasi disa prej tyre kanë funksion asistence/mbështetjeje në

mbarëvajtjen e punës, dhe si të tilla nuk janë përfshirë në këtë dokument. Gjithashtu, për shkak të gjendjes së Fatkeqësive Natyrore (Tërmeti 26.11.2019 dhe Pandemisë Covid-19), një pjesë e strukturave nuk kanë arritur të sjellin në kohë planet vjetore dhe nuk janë përfshirë në këtë dokument. Gjithsesi monitorimi i përmbushjes së objektivave dhe projekteve të këtyre strukturave do të vijojë përgjatë vitit, edhe objektivave që nuk janë realizuar apo përmbushur plotësisht.

Hartimi dhe zbatimi i këtij plani do të kontribuojë jo vetëm në përmbushjen e prioriteteve dhe objektivave që ka Bashkia e Tiranës për vitin 2021, por do të lehtësojë koordinimin mes strukturave si edhe do të përmirësojë ndjeshëm procesin e transparencës me qytetarët të cilët janë edhe përfituesit e drejtpërdrejtë nga përmbushja e objektivave.

**OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2021**

## **I. Përmirësimi i infrastrukturës arsimore dhe rritja e aksesit dhe gjithpërfshirjes në arsim**

Vizioni i BT-së në drejtim të sektorit të arsimit synon ofrimin e një infrastrukture moderne të institucioneve arsimore, që bazohet në plotësimin e nevojave dhe interesave të nxënësve dhe studentëve në Tiranë, për të garantuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies, sigurimin e standardeve dhe aksesit më të lartë nga të gjithë grupet shoqërore në të gjithë territorin, standarde në rezidencat universitare si dhe kthimin e institucioneve arsimore në qendra të rëndësishme komunitare.

Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës arsimore si dhe krijimi i infrastrukturave të reja do të vazhdojë të jetë një objektiv strategjik edhe për vitin 2021. Gjithashtu BT i ka dhënë prioritet më shumë se kurrë rritjes së aksesueshmërisë arsimore për grupet e pa favorizuara si fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në zona të thella rurale dhe ata me ndihmë ekonomike duke iu përmbajtur vizionit të saj dhe atij kombëtar.

Rezidencat universitare do të vazhdojnë të jenë në fokus të punës së BT edhe për këtë vit duke qenë se Tirana akomodon numrin më të lartë të studentëve në të gjithë Shqipërinë, kjo jo vetëm për faktin se në kryeqytete janë përqëndruar numri më i madh i institucioneve të arsimit të lartë por sepse metropoli ofron më shumë mundësi për punësim.

BT synon të nxisë shfrytëzimin maksimal të hapësirave të këtyre objekteve në funksion të edukimit dhe ndërveprimit të komunitetit nëpërmjet programit “Shkolla si Qendra Komunitare”.

## **II. Qytet i aksesueshëm dhe gjithpërfshirës**

PSBT për vitin 2021 e vë theksin në zhvillimin e një qyteti gjithpërfshirës, i cili është në funksion të qytetarëve dhe garanton një zhvillim të integruar ekonomik, social dhe territorial duke rritur mirëqënien e qytetit.

Tirana për të gjithë përbëhet nga një grup politikash me fokus rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe rritjen e aksesueshmërisë së qytetit nga të gjithë. Nëpërmjet këtij objekti, synohet përmirësimi i një sërë elementesh me impakt të drejtpërdrejtë tek çdo grupmoshë e popullsisë që përfshihen në territorin e BT-së.

Ky objektiv është një ndër më sfidueset dhe synon të nxisë mobilitetin alternativ nëpërmjet zgjerimit të rrjetit të korsive të dedikuara për biçikleta dhe përmirësimin të shërbimit të operatorëve në këtë fushë, të përmirësojë situatën e parkimit nëpërmjet rritjes së kapacitetit dhe përdorimin efiçent të hapësirave ekzistuese dhe përmirësimin të shërbimit të parkimit me pagesë. Vëmendje ka edhe transporti publik ku do të garantohet një sistem transporti i sigurt, miqësor ndaj mjedisit dhe me efiçencë të lartë për distanca mbi 5 km.

Hapësirat publike të gjelbra do vazhdojnë të jenë nën një proces transformimi të qëndrueshëm me qëllim shtimin e sipërfaqeve që i japin frymëmarrje qytetit. Vëmendje edhe për këtë vit do të kenë rehabilitimet e blloqeve të banimit si dhe nxitja e bashkëpunimit efektiv mes BT-së dhe qytetarëve për përmirësimin e infrastrukturës së objekteve në bashkëpronësi.

Përpjekjet e BT-së për të siguruar një qytet të pastër, me një sistem të mirë të menaxhimit të mbetjeve dhe të furnizimit me ujë do të vazhdojnë dhe zbatimi i projekteve të planifikuara do të japë efektet e pritshme për të gjithë qytetarët.

### **III. Rivitalizim urban që harmonizon infrastrukturën, shërbimet publike dhe nxit zhvillimin ekonomik**

Me reformën administrative territoriale BT tashmë përfshin një territor me një sipërfaqe rreth 25 herë më të madhe dhe heterogjene. Kjo ka nxitur projektimin e një sistemi policentrik që bazohet jo vetëm në praninë e disa epiqendrave urbane, me orientim ekonomik dhe shoqëror por edhe me ndërveprim dhe ndërvarësi që lindin prej tyre.

Dinamikat policentrike të ardhshme janë përcaktuar duke marrë në konsideratë praninë e sektorëve të rëndësishëm të ekonomisë, karakteristikat e veçanta shoqërore dhe sociale dhe profilet aktuale të zhvillimit. Krahas funksioneve kryesore për çdo pol është parashikuar

përmirësimi i shërbimeve bazike si shkolla, çerdhe, kopshte, infrastrukturë rrugore, parqe, qendra komunitare dhe kulturore, etj. Për secilin pol është parashikuar një kuotë ndërtimi në konvencion apo subvencion me shërbimet kryesore në mënyrë që të kthehen në zona të pëlqyeshme në çdo orë të ditës. Projektet që parashikohen të zbatohen për krijimin dhe funksionimin e pesë poleve urbane, gjatë vitit 2021 do të realizohen në tre shkallë:

*Policentrizëm në shkallë urban.* Në këtë fazë në vëmendje do të jenë rehabilitimi dhe mobilimi urban që përfshin infrastrukturën e rrjeteve inxhinjerie, rrjetit rrugor, hapësirave publike, sipërfaqeve të gjelbra, ndriçim etj

*Policentrizëm në shkallë lokale.* Fokusi në këtë fazë do të jetë mbi furnizimin me shërbime publike i epiqendrave dhe zonave përreth. Këtu përfshihen ndërtim/rehabilitim i shkollave, çerdheve dhe kopshteve, tregjeve publike, qendrave sociale, kënde lojrash, terrene sportive etj.

*Policentrizëm në shkallë territoriale.* Në këtë fazë do themelohen institucione/partneritete me komunitetin apo aktorë të tjerë të përfshirë që do të krijojnë tipare të dallueshme sipas karakterit të çdo poli.

#### **IV. Garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik**

Ekonomia e Tiranës në përgjithësi ka qenë dhe vazhdon të jetë e ushqyer nga sektorët e shërbimeve, tregtisë, ndërtimit dhe transportit. Si sektorët me prurjet më të mëdha të të ardhurave gëzojnë vëmendjen më të madhe dhe të vazhdueshme si nga pushteti vendor edhe nga ai qendror. Por tashmë, sipërfaqja e shumëfishuar e BT-së me 13 NJA-të rurale dhe kompetencat e reja që i kanë kaluar BT-së, evidentojnë nevojën për ti kushtuar vëmendje më të lartë zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë.

Qëllimi është të krijohen modele të qëndrueshme në tre aspektet/kolonat e veprimtarisë njerëzore: ekonomike, sociale dhe ekologjike. Zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomisë nënkupton gjetjen e një ekuilibri koherent dhe një harmonie afatgjatë në mes të këtyre tre kolonave. Kjo çështje ndërsektoriale do të jetë sfida edhe për vitin 2021 për BT, që duhet të marrë në konsideratë këto aspekte në përcaktimin dhe

zbatimin e politikave dhe duhet të përfshijë domosdoshmërisht pjesëmarrjen e vazhdueshme të të gjitha palëve të interesuara (qytetarët, bizneset, shoqatat, etj) si formë e suksesshme e demokracisë pjesëmarrëse.

Duke qenë se zhvillimi i ekonomisë është një proces transformimi në të cilin shfrytëzimi i burimeve natyrore, përzgjedhja e investimeve, orientimi i ndryshimeve teknologjike dhe institucionale realizohen duke garantuar qëndrueshmëri në të ardhmen, janë parashikuar programe e projekte që synojnë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për bizneset, mbështetje financiare dhe incentiva fiskale, ritja e konkurrueshmërisë dhe thithja e investimeve të huaja.

## **V. Forcimi i qeverisjes së mirë dhe respektimi i të drejtave të qytetarëve**

Qeverisja e mirë përbën një ndër kushtet thelbësore që duhet të plotësojë një shtet demokratik dhe sidomos aspirues për tu integruar në BE. Qeverisja e mirë fillon në nivel vendor dhe të njëjtat parime të qeverisjes së mirë, aplikohen edhe në nivel qendror. Këto parime janë shprehur qartë në Kartën Europiane të vetëqeverisjes vendore, të cilën Shqipëria është angazhuar ta zbatojë. Bazuar edhe tek parimi i subsidiaritit, përgjegjësitë publike duhet të ushtrohen nga autoritetet të cilat janë më pranë qytetarëve. Autoritetet e QV-ve janë në pozicionin më të mirë dhe më të informuar për të ndërmarrë veprime të suksesshme në nivel vendor dhe rajonal. Kjo nënkupton jo vetëm pushtet vendor por edhe përgjegjësi vendore. BT ka përcaktuar si prioritet të saj forcimin e qeverisjes së mirë dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve i cili do të realizohet nëpërmjet 3 programeve:

*Rritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore në nivel vendor* ka për qëllim funksionimin me efikasitet të lartë të sistemit të zhvillimit të kapaciteteve dhe burimeve njerëzore të administratës së BT-së në koordinim me planet dhe objektivat strategjike të institucionit me synimin e vetëm, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike.



*Sigurimi i një qeverisjeje transparente dhe rritja e llogaridhënies* ka për qëllim garantimin e një qeverisje të mirë të orientuar drejt qytetarëve. Vendimarrja vendore do të jetë gjithpëfshirëse dhe transparente dhe me pjesëmarrje të balancuar gjinore. Llogaridhënia në nivel vendor do të nxitet edhe nëpërmjet zbatimit të sistemeve të menaxhimit të performancës, që do të jenë instrumente objektive në transparencën dhe llogaridhënien e njësive të qeverisjes vendore.

*Forcimi i financave vendore* që ka për qëllim garantimin e një menaxhimi financiar të shëndoshë në BT. Praktikrat më të mira të menaxhimit financiar në nivelin do të shoqërohen me rritjen e llogaridhënies dhe kontrollin financiar për të shmangur abuzimet dhe korrupsionin në nivel vendor.

Për këtë objektiv në bashkëpunim me të gjitha strukturat e BT-së janë përcaktuar 3 programet dhe 7 aktivitetet/projektet të cilat do të bëjnë të mundur përmbushjen e këtij objekti. Në këtë plan janë përcaktuar gjithashtu edhe indikatorët të cilët do të përdoren për procesin e monitorimit dhe vlerësimit të përmbushjes së objektivit.

## **STRUKTURA E BT-SË DHE PLANET E DREJTORIVE TË PËRGJITHSHME**



Bashkia e Tiranës është e organizuar në 11 drejtori të përgjithshme në varësi të plotë nga Kryetari dhe nga 55 drejtori, kjo bazuar në Urdhërin e Kryetarit nr. prot. 1108, datë 10.01.2019 Për “Miratimin e Strukturës dhe Organikës të Institucionit të Bashkisë së Tiranës.” (i ndryshuar).

Bazuar në Rregulloren për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Tiranë, është krijuar një kuadër rregullator për funksionimin me efikasitet dhe eficiencë të administratës ku secila prej këtyre strukturave e ka të mirëpërcaktuar misionin dhe detyrat që duhet të realizojë. Detyrat rutinore administrative nuk janë përfshirë në PPBT pasi pavarësisht objektivave të cilat ndryshojnë nga viti në vit, këto detyra mbeten të njëjtat.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj administrata e BT-së bazohet në këto parime:

- parimi i barazisë
- parimi i ligjshmërisë
- parimi i ndalimit të konfliktit të interesit
- parimi i mbrojtjes së interesit publik
- parimi i vazhdimësisë
- parimi i transparencës
- parimi i ndershmërisë
- parimi i bashkëpunimit







## MONITORIMI I PLANIT STRATEGJIK TË BASHKISË TIRANË

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit kërkon përpjekje të përkushtuara, ekspertizë, aftësi, vlerësim dhe manaxhim të mirë. Ky proces konsiderohet si një nga më të rëndësishmit gjatë periudhës së zbatimit të PSBT për vitin 2021, pasi shmang devijimet nga përmbushja e objektivave. Me qëllim që të sigurohet një monitorim dhe raportim sa më cilësor dhe i dobishëm, është e nevojshme që të përcaktohet sa më poshtë vijon:

*Procesi i qartë i raportimit dhe i monitorimit.* Ky proces është mirëorganizuar brenda institucionit, pasi secila nga strukturat përveç planeve vjetore përgatit planet dhe raportimet mujore, ku cdo njësi përshkruan detyrat që do të realizojë si dhe detaje teknike ku shpjegohen edhe vonesat nëse ka të tilla.

*Modelet dhe instrumentet* që do të përdoren për monitorim. Formatet e raportimit janë të unifikuar dhe strukturuar në mënyrë të tillë që informacioni të jetë lehtësisht i kuptueshëm dhe i qartë si për ata që planifikojnë dhe raportojnë ashtu edhe për strukturat monitoruese.

*Kapaciteti i strukturave kryesore dhe pjesëmarrëse.* Të gjitha strukturat e BT-së janë njohur me procesin e planifikimit dhe të raportimit si dhe janë trajnuar mbi hedhjen e informacioneve në formatet përkatëse.

Struktura që do monitorojë PPBT me mbylljen e vitit 2021 do të përgatisë një matricë me të gjithë indikatorët e raportuar nga strukturat mbi realizimin e Planit, ku do të përshkruhen objektivat e përmbushura dhe në rast se ka objektiva apo projekte të pa-zbatuara do të jepen shpjegime për shkaqet e mosrealizimit.



**PLANI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË OBJKTEVE NË BASHKËPRONËSI, ADMINISTRIMIT TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE (DPOBANJAEC)**

Misioni:	DPOBANJAEC është përgjegjës për administrimin e çdo çështje që lidhet me sigurimin e ofrimit të shërbimeve në fushën e bashkëpronësisë dhe koordinimit me 24 Njësitë Administrative dhe 3 Lagjeve si dhe për mirëadministrimin e çdo çështje që lidhet me menaxhimin e rasteve të emergjencave civile duke marrë masat e duhura parandaluese dhe masa konkrete për minimizimin e pasojave.			
OBJEKTIVAT	PROJEKTE / AKTIVITETE		DREJTORIA PËRGJEGJËSE	INDIKATORËT
Realizimi i infrastruktures zgjedhore per zgjedhjet per Kuvendin e Shqiperise te dates 25.04.2021	1.1	Koordinimi me NJA për zbatimin e akteve të KQZ e Min. Brendshme për infrastrukturën zgjedhore	Drejtoria e Administrimit te Nja dhe AMTP	Realizimi me sukses
	1.2	Dërgimi në kohë i formularëve TIP me të dhënat për qendrat e votimit		Realizimi me sukses
	1.3	Organizimi i një seminary trajnues me koordinatorët zgjedhorë të NJA, në bashkëpunim me KQZ		Realizimi me sukses
Implementimi i listes se sherbimeve qe u jepen qytetareve te NJA-ve sipas urdhrin te Kryetarit te Bashkise Nr 29662 date 05.10.2016	2.1	Trajnim me stafin e NJA për njohjen me shërbimet dhe bazën ligjore		Realizimi me sukses
	2.2	Ofrimi i konsulencës mbi shërbimet dhe realitetin e tyre në marrëdhënie me qytetarin		Numri i konsultave
	2.3	Ofrimi i konsulencës mbi shërbimet dhe realitetin e tyre në marrëdhënie me qytetarin. Shoqërim në vendndodhje dhe ndërmjetësim me njësitë.		Numri i konsultave
Njohja dhe zbatimi i Rregulloreve "Per Detyrat Funktionale te Nderlidhesit me Komunitetin dhe Kryetareve te Fshatrave"	3.1	Takim me grupe të Ndërlidhjes me Komunitetin, për njohjen e detyrave të tyre funksionale.		Numri i Takimeve
	3.2	Takim me grupe të Kryetarëve të fshatrave, për njohjen e detyrave funksionale të tyre.		Numri i takimeve
Pjesemarrja dhe perfaqesimi i Bashkise Tirane dhe NJA ne rang nderinstitucional	4.1	Njohja e plotë e organizimit të Bashkisë Tiranë dhe përfaqësim në mbrojtje të interesave dhe qëllimeve të Bashkisë Tiranë.		Realizimi me sukses
Regjistrimi i AMTP-ve prane ASHK	5.1	Plotësimi i dokumentacionit, shqyrtimi dhe regjistrimi i AMTP-ve pranë ASHK-së.		Numri i AMPT
Hartimin e politikave për implementimin e projektit për Administrimin e Bashkëpronësisë.	6.1	Regjistrimi dhe formalizimi i strukturave të Kryesive	Drejtoria e Objekteve ne Bashkepronesi	Numri i kryesive të regjistruara
	6.2	Regjistrimi dhe formalizimi i Administratorëve		Numri i administratorëve të formalizuar.
	6.3	Regjistrimi dhe formalizimi i kontratave mes kryesive dhe administratorëve		Numri i kontratave
	6.4	Digjitalizimi ne sistemin Online për të gjitha objektet e banimit		Sistem online funksional
	6.5	Inspektimi i veprimtarise se administratoreve		Numri i inspektimeve
	6.6	Përcaktimi i standardeve minimale për ruajtjen e higjienës, shëndetit publik, mbrojtjen kundër zjarrit si dhe mirëmbajtjen fizike të mjediseve që janë pjesë e aktit të bashkëpronësisë		Rregullore e hartuar dhe e miratuar
Programi "Fondi i Komuniteteve"	7.1	Mbeshtetje me te gjitha Kryesite dhe administratoret e certifikuar per te nxitur aplikime te reja dhe ndjekja e te gjitha hapave per zbatimin e projekeve fituese		Numri i projekteve të miratuar
Nisma "Dhuro nje peme"	8.1	Bashkepunim me te gjithë administratorët për zhvillimin e kesaj nisme		Numri i pemeve
Mbeshtetje per Njesite Administrative	9.1	Mbeshtetje per NJA-te ne regjistrimin e banoreve ne kuader te ndryshimeve ligjore per rreqjen e takese se regjistrimit te vendbanimit		Realizimi me sukses



<b>Marrja e masave për parandalimin, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente që mund të krijohen nga fatkqësi natyrore ose nga dora e njeriut, në territorin që administrojnë Bashkia Tiranë.</b>	10.1	Pergatitja, miratimi dhe perditësimi i Planit Vendor te Emergjencave	<b>Drejtoria e Emergjencave Civile</b>	Marrje masash per parandalimin e riskut
	10.2	Përditësimi i sistemit te lajmerimit te Bashkisë Tiranë, Njësie Administrative, dhe institucioneve te varësisë		Sistem i perditësuar
	10.3	Ngritja e strukturave të përhershme ose të përkohshme, grupet e verifikimit ne terren te demeve ne rastet emergjente.		Rinovim ndryshime ne komisione
	10.4	Evidentimi dhe përcaktimi i të gjitha zonave me rrezik në territorin që përfshin Bashkia Tiranë.		Numri i zonave te evidentuara
	10.5	Kapacitetet në burime njerëzore e logjistike dhe gjendjes aktuale te vendeve për evakuimin e popullatës në rast emergjence.		Numri i ambienteve ne dispozicion dhe numri i grupeve operative
<b>Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe rehabilitimi për të arritur aftësinë ripërtëritëse me qëllim zvogëlimin e riskut të fatkeqësive në të ardhmen.</b>	11.1	Trajtimi me ndihmë financiare i banorëve të prekur nga fatkeqësi natyrore për mbulimin e dëmeve.		Numri i te demshperblyerve
	11.2	Marrëveshja për lejet e ndërtimit me institutin e Ndërtimit per qytetaret banesat e te cileve jane demtuar nga termeti		Numri i lejeve te miratuara
	11.3	Takime dhe konsultime me specialistët e njësie administrative dhe grupe vullnetare.		Numri i takimeve dhe numri i pjesemarrësve
	11.4	Kryerja e manovrave stërvitore/simulime.		Numri i manovrave
	11.5	Trajnime profesionale me qëllim rritjen e performances dhe efektivitetit ne realizimin me sukses te punes dhe objektivave		Numri i trajnimeve dhe numri i te trajnuarve
<b>Marrja e masave konkrete me qëllim parandalimin e rrezikut që mund të shkaktohet nga fatkeqesite natyrore</b>	12.1	Kryerja e raporteve teknike dhe rinovimi i marreveshjes me Institutin e Ndertimit per percaktimin e sakte te shkaqeve te demit		Percaktimi i shkaqeve dhe shkalla e ndertimit
	12.2	Kryerja e studimeve gjeologjike nga Sherbimi Gjeologjik nepermjet AKMC		Percaktimi i shkaqeve dhe shkalla e ndertimit
	12.3	Investime sipas buxhetit 2021		Numri i investimeve
	12.4	Ndjekja e procedurave per akt ekspertizat per pallatet e demtuara te kryera nga Instituti i Ndertimit		Numri i aktekspertizave
	12.5	Ndjekja e procedurave per akt ekspertizat per pallatet e demtuara te kryera nga Operatore Ekonomik		Numri i aktekspertizave te thelluara



**PLANI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT (DPPZHT)**

DPPZHT është përgjegjës për identifikimin e potencialeve dhe planifikimin e qëndrueshëm të territorit, për shqyrtimin, kontrollin dhe vlerësimin e kërkesave për lejimin e kryerjes së punimeve për zhvillimin e tokës ose të strukturës në të, mbikqyrjen dhe kontrollin e funksionimit të Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit për Bashkinë, të inventarit elektronik për rievime për projekte të ndryshme, azhurnimin në terren dhe hartimi i gentplaneve të ndryshme për leje zhvillimi

OBJEKTIVI		PROJEKTE / AKTIVITETE	DREJTORIA PËRGJEGJËSE	INDIKATORËT
<b>Hartimi i detyrave të objektivit mbështetur në objektivat e institucionit dhe në projektet e planifikuara për vitin 2021 nga Bashkia Tiranë</b>	1.1	Lagjet e Tiranës , rruga e Saracëve	<b>Drejtoria e Projektimit</b>	Realizimi në %
	1.2	Lagjet e Tiranës , rruga e Camëve -Hajdar Hidi		Realizimi në %
	1.3	Design Guidelines		Realizimi në %
	1.4	Galeria e qytetit të Tiranës ,Prefektura		Realizimi në %
	1.5	Zgjidhja e hapësirës publike dhe parkimit në blloqet ekzistuese		Realizimi në %
	1.6	Rehabilitimi i siluetës së qytetit (rikonceptimi i fasadave kryesore të Tiranës pa ndonjë vlerë të spikatur arkitektonike)		Realizimi në %
	1.7	Mobiliteti (zgjidhje e nyjeve të korsive të bicikletave)		Realizimi në %
	1.8	Rehabilitimi i hapësirës publike përgjatë Lanës (ura të reja kryesore ,rikualifikimi i urave ekzistuese ,krijimi i pistave të vrapit ,kënde lojërash)		Realizimi në %
	1.9	Trashëgimia e arkitekturës socialiste (rishikimi i blloqeve të banimit ,rikonstruksion,adaptim,shtesa )		Realizimi në %
	1.1	Shfrytëzimi i godinave ish-bujqësore në zonat rurale		Realizimi në %
	1.11	Godinat e edukimit (shkolla ,kopshte ,cerdhe)		Realizimi në %
	1.12	Shtëpia studio e Dritëro Agollit		Realizimi në %
	1.13	Hedhja e rrugëve të Planit Rregullues në genplanet e azhurnimit		Realizimi në %
	1.14	Hedhja e rrugëve në studimet pjesore urbane PDV		Realizimi në %
	1.15	Kthimi i përgjigjeve të qytetarëve		Realizimi në %
	1.16	Muzeu i Qytetit të Tiranës (Sarajet e Toptanëve/Libohovitëse)		Realizimi në %
	1.17	Cycling school		Realizimi në %
	1.18	Walkable City		Realizimi në %
	1.19	Zgjerimi i sipërfaqeve të varrezave publike Tufinë (ndërtimet infrastrukturore ,varrezat murale)		Realizimi në %
	1.2	Rrugët e reja të miratuara në PDV (projekt -zbatimi)		Realizimi në %

**PLANI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME JURIDIKE, ASETIVE DHE LICENCIMIT (DPJAL) 2021**

Misioni:	DPJAL është përgjegjëse për mirëadministrimin e çdo çështje që lidhet me garantimin e pajtueshmërisë së politikave të ndjekura nga Bashkia e Tiranës, në fushat ku kjo e fundit ushtron funksionet dhe veprimtarinë e saj, me kuadrin ligjor shqiptar, për mirëadministrimin e çdo çështje që lidhet me përfaqësimin sa më dinjitoz të Bashkisë së Tiranës në të gjitha konfliktet gjyqësore, për mirëadministrimin e çdo çështje që lidhet me identifikimin, regjistrimin dhe inventarizimin e pronave të paluajshme në pronësi të BT			
OBJEKTIVAT	PROJEKTE / AKTIVITETE		DREJTORIA PËRGJEGJËSE	INDIKATORËT
Ofrimit të vazhdueshëm të asistencës ligjore dhe juridike	1.1	Do të asistojë, mbështesë dhe japë konsulencën e nevojshme ligjore, në kohë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, mbi çështjet që kërkohen për t'u trajtuar nga Kryetari i Bashkisë:	Drejtoria Juridike	Dhenie asistence dhe permbushja e cdo kerkese
	1.2	Do të kontribuojë në zgjidhjen e kërkesave dhe problemeve që parashtrihen në rrugë administrative, për çështje me natyrë ligjore dhe juridike nga qytetarët dhe institucionet.		Harton plane pune dhe veprimi në lidhje me sigurimin e asistencës ligjore dhe juridike, mbi aktet ligjore dhe nënligjore, në lidhje me informimin, njohjen më të mirë, kuptimin, ndryshimet e legjislacionit në fuqi nga strukturat e Bashkisë së Tiranës
Perafrimi i legjislacionit në nivel vendor me direktivat e BE-se.	2.1	Zbatimin dhe respektimin e ligjit në çdo procedurë administrative që ndjek institucioni si dhe përmirësimin e standardit të legjislacionit të qeverisjes vendore, në funksion të përafrimit të legjislacionit tonë me atë të BE-së.		Legjislacioni i përafuar
Zbatimi i legjislacionit në fuqi për çështjet që i propozohen për miratim organeve të qeverisjes vendore	3.1	Do të asistojë në nismat dhe propozimet e Bashkisë së Tiranës për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, për fushat ku ushtron funksionet dhe veprimtarinë institucioni. Do të përgatisë propozime për lehtësimin e kuadrit ligjor të qeverisjes vendore, me anë të Projekt-Ligjeve, Projekt-Vendimeve, Projekt-Udhëzimeve të pushtetit qëndror etj, dhe dhënia e mendimeve dhe opinionëve ligjore në lidhje me to.		Numri i legjislacioneve të studiuara
	3.2	Do të sigurojë njohjen me legjislacionin që është në fuqi, si dhe ndryshimet e tij, nga strukturat e Bashkisë së Tiranës.		Siguron një sistem të shëndoshë të kontrollit të brendshëm për administrimin teknik të informacionit mbi bazën ligjore dhe nënligjore në nivel qëndror dhe vendor
Krijimi i nje biblioteke ligjore	4.1	Do të përditësojë Bibliotekën Ligjore (elektronike) nëpërmjet afishimit të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, apo përmbledhjeve ligjore dhe botimeve të ndryshme në këtë fushë.		Përmbledhje ligjore e përfunduar
Hartimi i vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave	5.1	Konsulenca dhe asistenca ligjore e nevojshme mbi çështjet që kërkohen për t'u trajtuar nga Kryetari i Bashkisë, (vendime, urdhëra, urdhëresa) në ushtrimin e funksioneve dhe kryerjen e detyrave të tij si edhe të gjithë strukturave të Bashkisë	Numri i vendimeve, urdhrave, urdhëresave	
Respektimi i afateve të përcaktuara në kryerjen e detyrave në sektorin administrativ dhe gjyqësor.	6.1	Përgatit në kohë dhe me cilësi materiale informuese për eprorët, me qëllim arritjen e objektivave dhe përmbushjen e detyrave të njësisë organizative;	Drejtoria e Ankimimeve	Fitimi I te gjitha proceseve gjyqësore te themelit.
Përgatitja me saktësi e materialeve, praktikave shkresore dhe informacioneve që lidhen me detyrat e pozicionit të punës apo të ngarkuara sipas rastit.	7.1	Merr masa për grumbullimin e informacioneve të kërkuara dhe përpunimin e të dhënave në afatet e përcaktuara		Fitimi I te gjitha masave te sigurimit te padisë.
Planifikimi dhe përmbushja e detyrave te ngarkuara në mënyrë profesionale;	8.1	Diskuton rezultatet e punës me eprorin dhe i referohet atij në rastet e problematikave apo çështjeve që kërkojnë zgjidhje me miratimin e tij.		Pjesëmarrje dinjitoze ne te gjitha proceset gjyqësore.
Identifikon mundësitë për përmirësimin e mëtejshëm të procedurave dhe teknikave të përdorura në përmbushjen e detyrave.	9.1	Jep kontributin e tij në përfundimet e çështjeve teknike në sektor.		Shqyrtim objektiv dhe I shpejte I ankimeve administrative.



**PLANI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË MANAXHIMIT FINANCIAR (DPMF) 2021**

<b>Misioni:</b>	DPMF është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha fazave të procesit buxhetor të Aparatit të Bashkisë së Tiranës, për menaxhimin dhe sigurimin e vlerave financiare dhe materiale, për administrimin e çdo çështje që lidhet me zhvillimin e praktikave të financimeve dhe mbështetjes donatore, për monitorimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë të ndërmarjeve me vetfinansim dhe SHA-ve,			
<b>OBJEKTIVAT</b>	<b>PROJEKTE / AKTIVITETE</b>		<b>DREJTORIA PËRGJEGJËSE</b>	<b>INDIKATORËT</b>
<b>Garantimi i nje menaxhimi financiar te shendoshe ne BT</b>	<b>1.1</b>	Paraqitja per miratim e kalendarit per PBA dhe per vitin buxhetor	<b>Drejtoria e Buxhetit</b>	PBA e hartuar dhe miratuar
	<b>1.2</b>	Përgatitja e Taveveve buxhetore per 3 vjecarin e ardhshem ne nivel vendor.		Përgatitja e taveveve
	<b>1.3</b>	Përgatitja e buxhetit për vitin e ardhshëm		Buxhet I hartuar, miratuar dhe publikuar
	<b>1.4</b>	Raportimi I Buxhetit		Raportim Monitorimi i Zbatimit te Buxhetit

**PLANI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE JASHTË (DPMPJ)**

Misioni:	DPMPJ është përgjegjëse për për mirëadministrimin e çështjeve që lidhen me koordinimin dhe monitorimin e veprimtarive dhe proceseve të cilat menaxhohen prej saj, në kuadër të bashkëpunimeve ndërinstitucionale, për publikimin e informacioneve në kohë reale në faqen web të institucionit, si dhe monitoron përditësimin, publikimin e informacioneve, lajmeve në kohë reale e rrjeteve sociale zyrtare për një komunikim transparent dhe në kohë reale me qytetarin			
OBJEKTIVAT	PROJEKTE / AKTIVITETE	DREJTORIA PËRGJEGJËSE	INDIKATORËT	
<p><b>1. Koordinimi I pjesëmarrjeve te Kryetarit/ Nenkryetareve ne evente te organizuara nga partnere/organizata/rrjete qytetesh te huaja.</b></p> <p><b>2. Koordinimi I takimeve te Kryetarit/Nenkryetareve me perfaqesues te misioneve diplomatike ne Shqiperi si dhe ndjekja e metejshme e bisedimeve mes paleve.</b></p> <p><b>3. Ndermjetesimi I komunikimit me partnere te huaj si dhe ndjekja e hapave per cdo bashkepunim te mundshem.</b></p>	<p><b>1.1</b> Takim zyrtar I Kryetarit me ambasadorin e ri te Maqedonise, SH.T.Z. Dancho Markovski.</p> <p>Pjesemarrja e Kryetarit ne forumin virtual “Basel Peace Forum” dhe “Mayors Forum”: “Accelerating adaption in cities”.</p> <p>Pjesemarrje e Kryetarit ne nje séance virtuale me Dalai Lama dhe “Leading Social and Economic Recovery”.</p>	<p><b>Drejtoria e Marredhenieve me Jashte</b></p>	Realizimi me sukses	
	<p><b>1.2</b> Pjesemarrje e Kryetarit ne evenimentin virtual te rrjetit “Transforming Transportation” organizuar nga World Bank Group. Pjesemarrje e Kryetarit ne takim virtual te rrjetit ICLEI: European Regional Executive Committee”.</p> <p>Pjesemarrje e Kryetarit ne konferencen :Annual City Development: Smart and Sustainable City”.</p> <p>Pjesemarrja e Kryetarit ne séance virtuale organizuar nga Bloomberg Harvard City Leadership Initiative “Leading Social and Economic Recovery”.</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>1.3</b> Pjesemarrje e Kryetarit ne seancen virtuale organizuar nga Bloomberg Harvard City Leadership Initiative “Leading Social and Economic Recovery”.</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>1.4</b> Pjesemarrje e Kryetarit ne ICLEI World Congress</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>1.5</b> Pjesemarrje e Kryetarit ne Urban Future Global Conference- Rotterdam, Hollande</p>		Realizimi me sukses	
<p><b>Mireadministrimi I te gjitha proceseve</b></p>	<p><b>2.1</b> Shtimi I sherbimeve dhe dalja live ne sistemin e ri (OSSH) te protokollimit dhe administrimit te kerkesave/ankesave/aplikimeve te ardhurave nga te gjitha rruget e komunikimit ne SISHQ dhe SKEQ</p>	<p><b>Drejtoria e Komunikimit me Qytetaret</b></p>	Numri i sherbimeve te shtuara	
	<p><b>2.2</b> Ofrimi dhe monitorimi I sherbimeve te standartizuara, cilesore dhe te shpejta, informimi ne kohe reale per cdo sherbim te ri qe ofron BT-ja dhe sigurimi qe stafi perditeson informacionin e ri ne kohe, trajnimi I vazhdueshem I te gjithë specialisteve mbi procedurat lidhur me te</p>		Numri i sherbimeve te permiresuara	
	<p><b>2.3</b> Raportimi mujor dhe periodik I te dhenave statistikore te volumeve te punes dhe afishimi I tyre ne Open Data.</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>2.4</b> Permiresimi I kushteve te punes per punonjesit e SKEQ. Kerkese per ambjent me te madhpune, pajisje logjistike si tavolina, fotokopje etj.</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>2.5</b> Perfundimi I sondazhit Tirana Solidare.</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>2.6</b> Zhvillimi I sondazhit mbi vleresimin qytetar per punen dhe veprimtarine e BT dhe/ose te lidereshipit.</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>2.7</b> Zhvillimi I sondazhit per shpalljen e Tiranës "Kryeqyteti Europian I Rinise 2022."</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>2.8</b> Zhvillimi I sondazhit per risite dhe lehtesimin e procedurave nepermjet aplikacioneve, portaleve dhe aplikimeve onlin.</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>2.9</b> Zhvillimi I sondazhit per pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve.</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>2.1</b> Zhvillimi I sondazhit per nxitjen e mobilitetit alternativ, permiresimi I transportit publik dhe parkimit.</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>2.11</b> Zhvillimi I sondazhit infrastruktura ne objektet arsimore.</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>2.12</b> Zhvillimi I sondazhit per rindertimin e Piramides dhe/ose kopshti Zoologjik e Botanik, Blv. Zogu I I-re.</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>2.13</b> Zhvillimi I sondazhit per furnizimin me uje.</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>2.14</b> Zhvillimi I sondazhit per programet e punesimit dhe mbeshtetja ndaj bizneseve te reja.</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>2.15</b> Zhvillimi I sondazhit mbi projektbuxhetin e BT per vitin 2022</p>		Realizimi me sukses	
	<p><b>2.16</b> Zhvillimi I sondazhit per programet e rindertimit.</p>		Realizimi me sukses	
<p><b>Realizimi dhe organizimi I pritjeve, aktiviteve, diteve festive sipas protokollit ceremonial</b></p>	<p><b>3.1</b> Organizimi I 33 aktiviteve te ndryshme ne kuader te kalendarit te festave zyrtare dhe diteve festive</p>	<p><b>Drejtoria e Protokollit dhe Ceremonialit Zyrtar</b></p>	Numri i aktiviteve te realizuara	
	<p><b>3.2</b> Asistence Protokollare per veprime te paparashikuara ne mbeshtetje te axhendes se kryetarit</p>		Numri i aktiviteve te realizuara	



**PLANI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, INOVACIONIT DHE TE DHENAVE (DPTIIDH)**

Misioni:	DPTIS është përgjegjëse për mirëadministrimin e çdo çështje që lidhet me zhvillimin dhe promovimin e strategjisë së sistemeve dhe infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, monitorimin dhe raportimin e funksionimit dhe vazhdimësisë së sistemeve dhe infrastrukturës informatike dhe për administrimin e grumbullimit të të dhënave dhe përpunimin e treguesve statistikore dhe gjeohapsinorë.		
OBJEKTIVAT	PROJEKTE / AKTIVITETE	DREJTORIA PËRGJEGJËSE	INDIKATORËT
<b>Implementimi i sistemeve dixhitale në fusha të ndryshme në funksion të lehtësimit të përmbushjes së funksioneve që ka BT dhe ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve dhe bizneseve</b>	1.1 1. Dhënia e nivelit të parë të ndihmës për të gjitha pajisjet elektronike të institucionit të Bashkisë së Tiranës. 2. Konfigurim dhe instalim të specializuar për përdoruesit në Domain, Mail server, dhe sistemet e tjera elektronike. 3. e-mail zyrtar/ e-Albania	<b>Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit</b>	Ofrim i shërbimeve IT per stafin ne kohe reale.
	1.2 Mirëmbajtja e Infrastrukturës së Rrjetit të Bashkisë Tiranë		Ofrimi i shërbimit ne menyre te pandërprerë
	1.3 Mirëmbajtje dhe zhvillim i platformës "Cloud-Bashkia Tiranë"		Përditësim të sistemit, Rritja e numrit të përdoruesve.
	1.4 Mirëmbajtja e website-ve të Institucioneve të varësisë		Perditesim i informacionit
	1.5 Ofrimi i shërbimit Free WiFi		Rritja e numrit të përdoruesve
	1.6 Ndjekja e kontratës: me objekt "Sistemi i Qendëruar Për Menaxhimin E Hoteleve Dhe Taksave Të Qëndrimit Në Bashkinë Tiranë"		Sistemi eshte funksional
	1.7 Ndjekja e kontratës me objekt "Forcimi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit Në Bashkinë e Tiranës"		Sistemi eshte funksional
	1.8 Ndjekja e kontratës me objekt "Linearizimi Financiar në Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë"		Sistemi eshte funksional
	1.9 Ndjekja e kontratës me objekt "Sistemi Elektronik i Inventarizimit, Regjistrimit dhe Përdorimit të Aseteve të Bashkisë Tiranë"		Sistemi eshte funksional
	1.10 Ndjekja e kontratës me objekt "Linearizimi i Menaxhimit të Aseteve në Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë"		Sistemi eshte funksional
	1.11 Ndjekja e kontratës me objekt "website i Ri (+Intranet) " Bashkia Tirane		Website eshte funksional, Rritja e numrit të përdoruesve
	1.12 Ndjekja e kontratës me objekt "Dixhitalizimi i Vlerësimit të Performancës"		Sistem i implementuar dhe funksional, Rritja e % së stafit përdorues.
	1.13 Ofrimi i shërbimeve ekiosk në Nja.A.		Rritja e numrit i shërbimeve te ofruara per qytetaret, nëpërmjet sistemit
	1.14 Ndjekja e kontratës me objekt " Zhvillimi I infrastrukturës së teknologjisë së Informacionit dhe Sistemi i Checkimit të Kartave të Aksesit në Bashkinë Tiranë"		Sistemi është funksional
	1.15 Ndjekja e kontratës me objekt "Modernizimi i dhomës së serverave në Bashkinë Tiranë"		Objekti është funksional
